



**Analizë e raportit të Komitetit për Partneritet Publiko-Privat në lidhje me shpalljen me interes publik të projekteve të kompanive Envidity dhe SharrCem**

## Përmbledhje ekzekutive

Para deputetëve të Kuvendit të Kosovës janë vendimet e Qeverisë të datës 25 gusht 2016 me të cilat konstatohet interesi publik për investimet e kompanisë Envidity Energy Kosova LLC përkatësisht Sharr Cem dhe Titan America. Në mandatin e deputetëve, këto do të jenë ndër vendimet më të rëndësishme të kësaj legjislature, dhe pa dyshim, vendimet me më së shumti ndikim në jetën e qytetarëve të Republikës së Kosovës. Aprovimi i vendimit për shpallje të interesit publik për këto dy projekte do të nënkuptonte hapje e rrugës për dy projekte me kosto katastrofale ambientale, shëndetësore e sociale që për qindra herë tejlakojnë përfitimet ekonomike. Kjo do të jetë hera e vetme që deputetët do të kenë mundësi që në mbrojtje të interesit publik të ktheni prapa këto vendime dhe të ndalni degradimin mjedisor dhe social që rrezikohet nga to.

Për ne si organizata të shoqërisë civile, interesi publik nuk mund të kufizohet asesi në thjeshtë sasinë e mjeteve që premtohen për t'u investuar. Komisioni qeveritar i Partneritetit Publiko-Privat dhe i themeluar në bazë të Ligjit Nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko-Privat do të duhej që së paku të merrte në konsideratë parimet e vendosura në këtë ligj para se të aprovonte propozimin për shpallje të interesit publik. Gjithashtu, siguria e furnizimit me energji nuk është

Ne gjithashtu jemi të bindur që si përfaqësues të popullit, duhet të keni parasysh nenin 52 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës që përcakton përgjegjësinë që kanë institucionet e vendit për të garantuar qytetarëve mundësinë për të ndikuar në vendimet që prekin mjedisin jetësor ku ata jetojnë. Si organ përfaqësues i qytetarëve, u takon juve që duke votuar kundër këtyre projekteve të mbroni, mjedisin e tyre jetësor, burimet nëntokësore ujore, kualitetin e ajërit, pronat e tyre etj.

Gasifikimi i qymyrit për të krijuar naftë sintetike dhe kerozinë është një teknologji që nuk ka përdorim në vendet e Bashkimit Evropian. Coal-To-Liquid (CTL) ka gjetur përdorim kryesisht aziatike dhe afrikane dhe është treguar shkatërruese për ambientin. Në të gjitha ato vende, është treguar që kjo teknologji rrezikon ndotjen e tokës së punueshme, ndotjen shkatërruese të ujërave nëntokësore, emetim të gazeve të rrezikshme për ambientin dhe hargjon një sasi të madhe të ujit për operim.

Edhe pse investimet do të jenë mbi 30 milion, përfitimi i shtetit do të jetë minimal. Në fakt, përfitimi i vetëm do të jetë mbledhja e tantiemës së thëngjillit, por e cila në total do të jetë rreth 70 milion euro dhe jo më shumë. Investimi do të jetë privat dhe ajo që do të lëjë mbrapa do të jenë vetëm kostot ambientale dhe sociale dhe asnjë shërbim tjetër ndaj qytetarëve. Në fakt, në bazë të Ligjit Nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko-Privat në bazë të së cilit ka vepruar edhe Komiteti i PPP-së për këto projekte, partneriteti i tillë nuk është as kontraktues e as institucional në bazë të definimeve të atij ligji. Me të, vetëm merren përsipër rreziqet dhe nuk ekziston asnjë përfitim real për publikun.

Projekti i SharrCem dhe Titan America nuk ofron asnjë përfitim të dukshëm publik dhe ofron vetëm një burim për kompaninë që të furnizojë me qymyr të tharë kompanitë e tij partnere. Për më shumë, do të ketë hapje të miheve të reja dhe jo shfrytëzim i atyre ekzistuese çka do të mund të sillte pak dobi nga projekti. Në formën e tanishme, do të ketë vetëm mihe të reja me emetim të gazeve të dëmshme dhe përfitimet do të jenë vetëm të operatorit ekonomik dhe jo të shtetit.

Ky projekt medoemos do të shkaktojë zhvendosje të qytetarëve. Tashmë dihen pasojat sociale të një procesi të tillë. Rasti i zhvendosjes së fshatit Hade në komunën e Obiliqit ka treguar se si mund të ketë pasoja të rënda sociale dhe shkelje të të drejtave të njeriut. Degradimi i këtyre pjesëve mund të dëmtojë kulturat bujqësore dhe blegtorale, turizmin, biodiversitetin etj.

Duke konsideruar të gjitha këto arsye, ne konsiderojmë që konsiderojmë që përgjigja e vetme ndaj këtyre projekteve duhet të jetë negative. Ato e kthejnë Kosovën prapa dhe nuk janë në pajtim me standardet mjedisore dhe të ardhmen evropiane të vendit. Si deputet të Kuvendit të Kosovës, mendojmë që interesin publik duhet ta shihni vetëm nga prizmi i përfitimit të qytetarëve dhe shtetit dhe jo të zhvillimit të një aktiviteti ekonomik që potencialisht do t'i sjellë përfitime investitorit por me siguri do t'i sjellë dëme vendit.

## Prapavija

Në maj të vitit 2013, u publikua në gazetën zyrtare Ligji Nr. 04/L-158 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet. Në bazë të ndryshimit të ri, neni 18 i ligjit bazik, paragrafi 7 u riformulua:

*Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme të këtij neni, shprehimisht përcaktohet se kërkesa për proces konkurrues të tenderimit sipas paragrafit 1. të këtij neni nuk do të aplikohet për një licencë për një Mineral Energjetik nëse, për shkaqe që ndërlidhen drejtpërdrejt me nevojën për të siguruar sigurinë e furnizimit energjetik ose tërheqjen e investimeve të konsiderueshme direkte në Kosovë, Komiteti për PPP i rekomandon Qeverisë vendimin për aprovim me të cilin konstaton se ka interes publik në lëshimin e kësaj licence për një investitor specifik, Qeveria nxjerr një vendim të tillë të cilin e dërgon për miratim në Kuvend. Pas miratimit nga Kuvendi, KPMM duhet të lëshoj licencën atij investitori, me kusht që kushtet e licencës të jenë në përputhshmëri me dispozitat e aplikueshme të këtij ligji dhe investitori i përmbush të gjitha kriteret e kualifikimit të përcaktuara sipas këtij ligji.<sup>1</sup>*

Edhe në dokumentin për informatat e projektit është sqaruar që vendimi për ndryshimin e ligjit është marrë me qëllim të shmangies së procedurave konkurruese të tenderimit.<sup>2</sup> Kësisoj, po i hapej rrugë mundësisë që një licencat për hulumtim dhe eksploatim të mineralit të jepeshin edhe pa një proces konkurrues me kusht që projektet e paraqitura të përbënin interes publik.

## Shpallja e interesit publik, definimi ligjor dhe rasti i tanishëm

Definimi i interesit publik në kuptim të përgjithshëm është i vështirë. Ai definohet ndryshëm për sektorë të ndryshëm që rregullohen. Më e rëndësishme se kjo, definimi i interesit të përgjithshëm varet nga pozicioni i vendimmarrësit. Për Qeverinë e Kosovës, niveli i investimeve mund të shihet si arsye e vetme për të shpallur interesin publik. Megjithatë, për deputetët e Kuvendit të Kosovës që përfaqësojnë qytetarët e Republikës së Kosovës, niveli i mjeteve që do të investohen apo siguria e furnizimit nuk mund të jenë arsye të vetme për shpallje të interesit publik.

<sup>1</sup> Republika e Kosovës, (2013), Ligji Nr. 04/L-158 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, Neni 13, paragrafi 4 që ndryshon nenin 18 paragrafin 7 të ligjit bazik, i qasshëm në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2702> (qasur në shtator 2016).

<sup>2</sup> Ministria e Financave e Republikës së Kosovës, (2016), Raport Vleësimi për Projektin të Kompanisë ENVIDITY, Prishtinë: MF.

Ligji Nr. 04/L-158 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale përcakton kushtet sipas së cilave do të shmanget procedura e tenderimit konkurrues dhe një projekt do të shpallej me interes publik. Shmangja e procedurave konkurruese do të bëhej nga një Komitet për Partneritet Publiko Privat i themeluar sipas Ligjit Nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko-Privat.

Shpallja e interesit publik në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr. 04/L-158 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-163 do të bëhej në shmangie të procedurave konkurruese vetëm *për shkaqe që ndërlidhen drejtpërdrejt me:*

- 1) *nevojën për të siguruar sigurinë e furnizimit energjetik ose*
- 2) *tërheqjen e investimeve të konsiderueshme direkte në Kosovë.*

Këto dy kushte për përjashtimin e procesit konkurrues nuk duhet të plotësohen kumulativisht, pra **mjafton që vetëm njëri kusht të plotësohet.**<sup>3</sup> Pra, ky raport vlerësimi sqaron që në rast se njëri kusht plotësohet, kushti tjetër për shpallje të interesit publik mund të mos plotësohet fare. Por megjithatë, sqaron dokumenti, *kjo dispozitë nuk ka përcaktuar kritere të qarta ligjore për vlerësimin e këtyre dy kushteve. Prandaj, parashtrohet dilema, se në bazë të cilave kritere duhet të bëhet vlerësimi i përmbushjes së këtyre dy kushteve të lartëcekura.*<sup>4</sup> Pra, edhe Komiteti për Partneritet Publiko-Privat, i themeluar nga kjo dispozitë ligjore, kishte probleme të definonte se cilat ishin kriteret për të përcaktuar përmbushjen e këtyre dy kushteve për shpallje të interesit publik.

Por më e rëndësishmja në këtë mes ishte nëse kushtet e përcaktuara nga Neni 13 i Ligjit Nr. 04/L-158 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-163 përbëjnë kushtet e vetme që një Partneritetit Publiko-Privat të konstituohet.

Ligji Nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko-Privat, që siç e shpjeguam përbën bazën ligjore të themelimit të secilit Komitet për Partneritet Publiko-Privat përcakton kushtet për vendosjen dhe zbatimin e një Partneriteti Publiko Privat:

*Dhënia dhe zbatimi i një Partneriteti Publiko Privat bëhet në bazë të:*

- *parimeve të trajtimit të barabartë,*
- *mos-diskriminimit, transparencës,*
- *proporcionalitetit,*
- *ekonomicitetit,*
- *efikasitetit,*
- *mbrojtjes së interesit publik,*
- *konkurrencës së lirë,*
- *vlerës-për-paranë dhe*
- *përballueshmërisë.*<sup>5</sup>

<sup>3</sup> Ministria e Financave e Republikës së Kosovës, (2016), Raport Vlerësimi për Projektin PROMETHEUS nga SHARR CEM.

<sup>4</sup> Ibid, faqe 4.

<sup>5</sup> Republika e Kosovës, (2011), Ligji Nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko Privat, Neni 4, i qasshëm në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2784> (qasur në shtator, 2016)

Përkundër kësaj, Komiteti i PPP-së ka vendosur që të marrë për bazë vetëm kushtet e parapara në ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale, edhe pse mandati i tij buron vetëm nga Ligji Nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko-Privat. Gjithashtu, Ligji Nr. 03/L-158 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale që paraqiste dy kushte të vetme për shpallje të interesit publik të ndara nga lidhësa veçuese “ose”, ka hyrë në fuqi në maj 2013. Kërkesat për licenca nga kompania Envidity Energy Kosova LLC kishin mbërritur në KPMM më 20 maj, 2013 ndërsa vetëm tre muaj pas miratimit të ligjit, ajo kishte aplikuar për lëshim të licencës pa proces konkurrues.<sup>6</sup> Dhe dokumentacioni përpara jush pranon që ky ndryshim ligjor është bërë vetëm për ta shtruar bazën ligjore për këtë kërkesë.

Edhe pse është marrë për bazë vetëm kjo dispozitë, insistimi që të shpallet me interes publik duke u bazuar vetëm në sasinë e mjeteve të investuara (mbi 30 ml) pa pasur në konsideratë edhe kost-benefitin e projektit nuk mund të jetë bazë e mjaftueshme për deputetë e Kuvendit të Kosovës që të votojnë pro këtij vendimi.

Definimi i interesit publik duhet parë nga këndvështrimi i mandatit të deputetit. Dhe Kushtetuta parasheh që në përshkrimin e kompetencave të Kuvendit ka paraparë që Kuvendi vendos për çështjet me interes të përgjithshëm, të përcaktuara me ligj.<sup>7</sup> Gjithashtu, në pjesën e ushtrimit të funksionit të deputetit (neni 74) përmendet pikërisht ushtrimi i rolit të deputetëve “*në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës*”. Para se një projekt të shpallej interes publik, duhet me doemos të merreshin në konsideratë edhe aspektet mjedisore të tij.

Në vendimin e Qeverisë për konstatimin e interesit publik për lëshimin e licencës për këta operator thuhet që Marrëveshja mund të finalizohet pas vendimit nga Kuvendi i Kosovës me kusht që:

*Ajo marrëveshje për investim është nëpërputhshmëri me ligjin e aplikueshëm;*

*Marrëveshja për investim i plotëson kushtet e licencimit të përcaktuara me ligj dhe*

*Marrëveshja për investim përfshinë përfitime si dhe shpërndarje optimale të rrezikut për Republikën e Kosovës duke tërhequr investime të konsiderueshme direkte apo sigurimin e sigurisë së furnizimit energjetik.<sup>8</sup>*

Për deputetët e Kuvendit të Kosovës nuk mund të mjaftojë vetëm shpjegimi se do të investohen mbi 30 milion euro. Nëse në këtë fazë nuk është e nevojshme të shtjellohen kostot ambientale dhe sociale të projekteve të tilla, përse janë përmendur këto kushte në vendimin qeveritar.

Një vendim me impakt ambiental nuk mund të merret pa konsultim me qytetarët mjedisi i të cilëve do të preket.

<sup>6</sup> Ministria e Financave e Republikës së Kosovës, (2016), Raport Vleësimi për Projektin të Kompanisë ENVIDITY, Prishtinë: MF

<sup>7</sup> Republika e Kosovës, (2008), Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 65, Kompetencat e Kuvendit, Prishtinë: GZRKS.

<sup>8</sup> Qeveria e Republikës së Kosovës, (2016), Vendimet Nr. 04/106 dhe 05/106 për Aprovimin e propozimit të Ministrisë së Financave për miratimin e vendimit të Komitetit për Partneritet Publiko Privat me të cilin konstatohet interesi publik nga lëshimi i licencës për Projektin e Kompanisë Envidity Energy Kosova LLC përkatësisht SharrCem dhe Titan America, të qasshme në [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet\\_e\\_Mbledhjes\\_se\\_106-te\\_te\\_Qeverise\\_se\\_Republikes\\_se\\_Kosoves\\_2016.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_106-te_te_Qeverise_se_Republikes_se_Kosoves_2016.pdf) (qasur në shtator 2016).

***Institucionet e pushtetit publik angazhohen për t'i garantuar secilit mundësinë që të ndikojë në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor ku ajo/ai jeton.<sup>9</sup>***

Deputetët e Kuvendit të Kosovës, si përfaqësues të qytetarëve, nuk mund të marrin vendim për shpallje të interesit publik për një projekt i cili drejtpërdrejtë do të prekë ambientin e tyre jetësor. Pa përfshirje të qytetarëve në vendimmarrje për këto projekte nuk mund të ketë implementim të një projekti të tillë.

Për arsye të lartpërmendura, konsiderojmë që shpallja e interesit publik, ligjërisht është e kontestueshme. Në vazhdim do të flasim për ndikimin mjedisor dhe social i realizimit të projekteve të tilla dhe përse Kosova nuk mund të mbajë një barrë të tillë mbi supe.

## **Ndikimi mjedisor dhe social**

### **Derivatet nga qymyri në të lëngshme**

Kapaciteti botëror i prodhimit të naftës sintetike është mbi 240,000 barel në ditë (38,000 m<sup>3</sup>/d)<sup>10</sup>. Duhet bërë dallimin në mes të teknologjive të ndryshme të gasifikimit nëntokësor dhe atë së paku në tre lloje të ndryshme:

- Nga Qymyri në të Lëngshme (Coal-to-Liquids) – Projekti i Envidity
- Nga Qymyri në Gaze (Coal-to-Gas)
- Nga Qymyri në Kemikate (Coal-to-Chemicals)<sup>11</sup>

Në përgjithësi, teknologjia e gasifikimit nëntokësor përfshinë shpimin e dy puseve të cilat kanë një distancë në mes tyre dhe të cilat shkojnë direkt tek shtresa (damari) i qymyrit nëntokësor. Shtresa e qymyrit ndodhet në mes të dy puseve dhe të dy lidhen përmes sistemit të shpimit direkt. Ajëri futet nga pusi injektues së bashku me disa katalizator që janë të domosdoshëm për kryerjen e një sërë reaksionesh kimike për të prodhuar syngasin e parë që bërëhet nga një përzierje e dioksidit të karbonit (CO<sub>2</sub>), hidrogjenit (H<sub>2</sub>), metanit (CH<sub>4</sub>), monoksidit të karbonit (CO) dhe ndotësve të tjerë duke përfshirë squfurin dhe metale të rënda. Përzierja e këtij gasi shkon nëpër gypin tjetër në pusin e prodhimit për tu trajtuar.<sup>12</sup> Syngasi mund të përdoret si bazë për prodhimin e një varieteti produktesh, si në rastin e Envidity naftës sintetike dhe kerozinës.

---

<sup>9</sup> Republika e Kosovës, (2008), Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 52, Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor, paragrafi 2, Prishtinë: GZRKS.

<sup>10</sup> Energy Information Administration, (2006) Annual Energy Outlook 2006 with Projections to 2030 <http://www.eia.gov/oiaf/archive/aeo06/pdf/issues.pdf> pp52-54.

<sup>11</sup> Friends of the Earth International, (2016), Fuelling the Fire, The chequered history of Underground Coal Gasification and Coal Chemicals around the world, i qasshëm në [http://www.foei.org/wp-content/uploads/2016/08/FoEI\\_Fuelling\\_the\\_Fire\\_July2016\\_FinalReport\\_erratum.pdf](http://www.foei.org/wp-content/uploads/2016/08/FoEI_Fuelling_the_Fire_July2016_FinalReport_erratum.pdf) (qasur në shtator, 2016)

<sup>12</sup> C. Higman, S. Tam, (2014), Advances in Coal Gas Cation, Hydrogeneration and Gas Treating for the Production of Chemicals and Fuels, Chemical Reviews, faqe 1676,




Figura 1. Gasifikimi nëntokësor i qymyrit. Burimi: FEI

Edhe pse ju si deputet të Kuvendit të Kosovës nuk është e thënë të njihni të gjitha aspektet teknike të teknologjisë së propozuar, është e rëndësishme të dihen impaktet dhe rreziqet ambientale që e shoqërojnë atë.

### Përdorimi i ujit

Kjo teknologji hargjon sasi të mëdha të ujit. Për shembull, nëse marrim projektin e Shenhua Group që prodhon me kapacitet 20,000 barel në ditë dhe teknologji të njëjtë sa kjo e propozuar nga Envidity, (shih të dhënat në listën e kompanive në tabelë), hargjon 14,4 milion m<sup>3</sup> ujë në vit.<sup>13</sup> Kjo është sa 30% e sasisë së ujit të pijshëm që konsumohet në Kosovë.<sup>14</sup> Për më tepër, i njëjti dokument i Agjencisë thotë që: “burimet e ujërave nëntokësore janë të kufizuara dhe gjenden kryesisht në pjesën Perendimore të Kosovë ndërsa burimet e ujërave sipërfaqësore janë më të mëdha në pjesën Lindore të

<sup>13</sup> Greenpeace East Asia, (2013) Thirsty Coal 2: Shenhua's Water Grab, e qasshme në <http://www.greenpeace.org/eastasia/Global/eastasia/publications/reports/climate-energy/2013/Thirsty%20Coal%202.pdf> (qasur në shtator, 2016).

<sup>14</sup> Agjencia e Statistikave e Kosovës, (2016), Statistikat e Ujërave në Kosovë 2015, e qasshme në <https://ask.rks-gov.net/sq/lf/24-statistikat-e-ujerave-ne-kosove-2015> (qasur në shtator, 2016).

Kosovës.”<sup>15</sup> Edhe pse përdorimi i një sasive të mëdha të ujit do të nënkuptonte një problem në vetëvetë, mundësia e ndotjes së ujërave nëntokësore përbën rrezikshmëri edhe më të lartë.

### **Ndotja e ujërave nëntokësore**

Projekti që ndodhet para deputetëve do të prekë pikërisht ujërat nëntokësore të pjesës perendimore të Kosovës të cilat, ndër të tjera, kanë edhe cilësi më të lartë sesa ujërat nëntokësore të pjesës lindore të Kosovës.<sup>16</sup> Djegja dhe gasifikimi nëntokësor nuk mund të bëhet pa shkaktuar ndotje. Në prill të këtij viti, ministri i minierave i Queensland të Australisë, z. Anthony Lynham njoftoi për ndalimin e gasifikimit nëntokësor duke pranuar që “askush nuk ka bërë ende një gasifikim nëntokësor të suksesshëm dhe fitimet potenciale nuk ia vlenin në krahasim me rrezikun ambiental”.<sup>17</sup> Këto deklarata u pasuan nga zbulimi i një dokumenti sekret qeveritar që fliste për qindra hektar tokë të kontaminuar nga kompania Linc Energy që kishte filluar operimin në vitin 2007.

Gjetjet kryesore të raportit flisnin që “dëmi ishte i shpërndarë gjerësisht, me impakt të madh dhe pjesërisht i pakthyeshëm”<sup>18</sup>. Raporti specifikonte që vetëm për të bërë një studim të mirëfillt të dëmeve do të shpenzoheshin miliona dhe se kostoja e riparimit dhe rehabilitimit të tokave do të ishte marramendëse.

### **Emetimet e CO2 dhe ndotësve të tjerë**

Siç e thamë, gjatë procesit të gasifikimit të qymyrit, lirohet një sasi e madhe e ndotësve. Ka një duzinë apo më shumë, relativisht kohëve të fundit, të centraleve “IGCC” që e kanë një njësi të integruar për gazifikimin e qymyrit, me një njësi të ciklit të kombinuar. Këto centrale “IGCC” kanë një normë të CO2 që është 20 për qind apo më shumë, më të ulët se centralet konvencionale të qymyrit.<sup>19</sup> Megjithatë, projekti i propozuar konsiston në faktin që kemi të bëjmë me teknologji nga qymyri në derivate të lëngshme dhe ky proces është intensiv me emetime të larta të CO2 dhe kërkon investime të mëdha në izolim dhe mbyllje të karbonit. Megjithatë, rasti i ndotjes në Australi na tregon që izolimi i ndotësve është praktikisht i pamundur për shkak të vet natyrës së procesit dhe lëndëve që digjen.

Një element me shumë rëndësi është definimi i hapësirës së realizimit të projektit. Projekti i SharrCem “kërkon të marrë licencën e shfrytëzimit për një sipërfaqe të pa definuar në këtë propozim me qëllim të mihjes së thëngjillit dhe përpunimit të tij me lëndë energjetike”.<sup>20</sup> Më tutje në raportin vlerësues është thënë që “të mos bllokohet perspektiva për zgjerim të minierave të KEK-ut,

<sup>15</sup> Ibid.

<sup>16</sup> Qeveria e Kosovës, (2015), Strategjia Shtetërore e Ujërave në Kosovë 2015 – 2034, Prishtinë.

<sup>17</sup> ABC news Australia, (2016), UCG banned immediately in Queensland, laws to follow, Mines Minister Anthony Lynham says, i qasshëm në <http://www.abc.net.au/news/2016-04-18/ucg-banned-immediately-in-qlld-laws-to-follow-anthony-lynham/7335172> (qasur në shtator, 2016).

<sup>18</sup> Marrë nga: Report on landform damage and alleged environmental harm from the Linc Energy Pilot trial, Chinchilla, Queensland June 2015: Gilbert & Sutherland., e qasshme në <http://www.abc.net.au/news/2015-08-10/linc-energy-key-findings/6681938> (qasur në shtator, 2016)

<sup>19</sup> KOSID, (2016), Intervistë me z. Bruce Buckheit, ish zyrtar i Agjencisë Amerikane për Mbrojtje të Mjedisit.

<sup>20</sup> Ministria e Financave e Republikës së Kosovës, (2016), Raport Vleësimi për Projektin të Kompanisë SharrCem & Titan America, Prishtinë: MF



rrjedhimisht hapësira për licenca të reja të KEK-ut në kuadër të kësaj përfshihet nevoja për furnizim me linjit të TC Kosova e Re”.<sup>21</sup>Përkundrazi, ne mendojmë që edhe pse projekti i SharrCem nuk do të sjellë asnjë përfitim ekonomik për Kosovën por vetëm për kompaninë, ka mundur që së paku të përdreshin mihjet ekzistuese të KEK. Në vend se të përdoret kjo teknologji si një justifikim për të hapur miniera të reja, unë do të rekomandoja që zhvilluesit të inkurajohen për të shtuar tharjen elinjitit për prodhimin ekzistues që shërben Kosovën A & B. Kjo do të zvogëlojë sasinë e thëngjillit që nxirret, dhe nevojën për zgjerimin e mëtejshëm të minierës, do të reduktojë CO2 (dhe emetimet e tjera ndotëse) dhe ndoshta do të rrisë kapacitetin gjenerues të këtyre termocentraleve. Në qoftë se ju digjni linjitshtesë për të tharë linjit para se ta transportoni atë në një central apo mulli çeliku konkret, përfitimet e tharjes janë të humbura.<sup>22</sup> Megjithatë, më tej në propozimin e tanishëm, ndonëse pa shtuar arsyeshmërinë ekonomike, sociale dhe mjedisore, është propozuar pjesa veriore e basenit të Dukagjinit.

Në vazhdim, është paraqitur lista e kompanive ekzistuese në botë që prodhojnë derivate të lëngshme sintetike nga qymyri, Coal-To-Liquid (CTL).

---

<sup>21</sup> Ibid, faqe 6.

<sup>22</sup> KOSID, (2016), Intervistë me z. Bruce Buckheit, ish zyrtar i Agjencisë Amerikane për Mbrojtje të Mjedisit.

Projektet nga Qymyr në të Lëngshme në Botë						
Projekti	Kompania	Lokacioni	Distanca nga zona e banimit (km)	Tipi	Produktet	Viti i fillimit
Sasol Synfuels II (West) & Sasol Synfuels III (East)	Sasol (Pty) Ltd.	Secunda, South Africa	4.8	CTL <sup>23</sup>	160,000 BPD <sup>24</sup> ; primary products gasoline and light olefins (alkenes)	1977(II)/1983(III)
<b>Shenhua Direct Coal Liquefaction Plant</b>	Shenhua Group	Ordos, Inner Mongolia, China	8.6	CTL	20,000 BPD; primary products diesel fuel, liquefied petroleum gas, naphtha	2008
Yitai CTL Plant	Yitai Coal Oil Manufacturing Co., Ltd.	Ordos, Zhungeer, China	10.5	CTL	160,000 mt/a Fischer-Tropsch liquids	2009
Jincheng MTG Plant	Jincheng Anthracite Mining Co., Ltd.	Jincheng, China	9.1	CTL	300,000 t/a methanol from MTG process	2009

<sup>23</sup> CTL – Coal To Liquid (Nga Qymyr në të Lëngshme).

<sup>24</sup> BPD – Barrel per Day (Barel në ditë)

<b>Sasol Synfuels</b>	Sasol (Pty) Ltd.	Secunda, Africa	South	5.1	CTL	3,960,000 (Nm <sup>3</sup> /d) syngas capacity; Fischer-Tropsch liquids	2011
<b>Shanxi Lu'an CTL Plant</b>	Shanxi Lu'an Co. Ltd.	Lu'an, China		7.6	CTL	160,000 mt/a Fischer-Tropsch liquids	2014
<b>ICM Coal to Liquids Plant</b>	Industrial Corporation of Mongolia (ICM) LLC	Tugrug Mongolia	Nuur,	56	CTL	13,200,000 (Nm <sup>3</sup> /d) syngas capacity; gasoline	2015
<b>Yitai Yili CTL Plant</b>	Yitai Yili Energy Co.	Yili, China		6.8	CTL	30,000 BPD Fischer-Tropsch liquids	2015
<b>Yitai Ordos CTL Plant Phase II</b>	Yitai	Ordos, Dalu, China	Zhungeer-	3.2	CTL	46,000 BPD Fischer-Tropsch liquids	2016
<b>Yitai Ürümqi CTL Plant</b>	Yitai	Guanquanbao, Urunqi, China		4.5	CTL	46,000 BPD Fischer-Tropsch liquids	2016
<b>Shenhua Ningxia CTL Project</b>	Shenhua Group Corporation Ltd	China, Ningxia	Yinchuan,	4.86	CTL	4 million tonnes/year of diesel & naphtha	2016

<b>Celanese Coal/Ethanol Project</b>	Celanese Corporation – PT Pertamina Joint Venture	Indonesia, Kalimantan or Sumatra	11.1	CTL	1.1 million tons of coal/year to produce ethanol	2016
<b>Clean Carbon Industries</b>	Clean Carbon Industries	Mozambique, Tete province	14.4	Coal waste-to-liquids	65,000 BPD fuel	2020
<b>Arckaringa Project</b>	Altona Energy	Australia, South	82	CTL	30,000 BPD Phase I 45,000 BPD + 840 MW Phase II	TBD

*Tabela 1. Lista e impianteve të gasifikimit nëntokësor me qymyr. Burimi: National Energy Technology Laboratory (NETL)*

Gjëja e parë që vërejmë nga lista e mësipërme është që asnjë vend evropian nuk ka të instaluar një kapacitet të tillë tani për tani. Kosova është një vend shumë i vogël për të eksperimentuar me një projekt aq të kushtueshëm.

### **Kostoja sociale**

Projektet e propozuara do të kenë kosto sociale për shkak se varësisht nga specifikimi gjeografik, ato do të imponojnë shpronësime dhe zhvendosje. Në aspektin ligjor shpronësimet do të ndodhin sipas paragrafit 2 të nenit 33 të Ligjit Nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale:

*Nëse, sipas paragrafit 1, nën-paragrafit 1.7 të nenit 31 të këtij ligji, parashtruesi i kërkesës ka siguruar dëshmi se një palë e tretë ka refuzuar ose ka dështuar të hyjë në një Marrëveshje mbi të Drejtat Sipërfaqësore e cila mbulon të drejtat sipërfaqësore që në mënyrë të arsyeshme kërkojnë nga parashtruesi i kërkesës për të ushtruar Programin e vet të Shfrytëzimit, KPMM i parashtron kërkesë – në pajtim me dispozitat e ligjit të aplikueshëm mbi shpronësimin – Qeverisë për shpronësimin e të drejtave të kërkuara sipërfaqësore dhe Qeveria do t'i shpronësojë këto të drejta. Pas përfundimit të procesit të shpronësimit, Qeveria i'a bart të drejtat sipërfaqësore parashtruesit të kërkesës për Licencë kur parashtruesi i kërkesës të ketë paguar shpenzimet e shpronësimit.<sup>25</sup>*

Plotësim ndryshimi ka shtuar edhe paragrafin 3 që parasheh mundësinë që ka Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale që pas procedurave të shpronësimit të kërkojë nga kompania pagesën në avans të tantimës. Me një fjalë, do të ketë shpronësim publik por me rimbursim nga ana e kompanisë implementuese. Këtu shfaqet edhe njëherë anomalia e trajtimit të këtyre projekteve si koncesione publike e në anën tjetër përfitimi komercial është tërësisht i koncentruar tek kompanitë dhe jo tek shteti. Në këtë rast nuk do të ketë as edhe një përfitim në kuptim të shërbimeve publike ose të ngjashme dhe për këtë arsye duhet që koston e zhvendosjes ta paguajn kompanitë në fjalë.

Procesi i zhvendosjes ka kosto të shumta sociale duke përfshirë:

- Ndikim në relacionet gjinore dhe dinamikat familjare, shëndetësore dhe të mirëqenies së komunitetit
- Ndikime në demografi, fertilitet dhe shëndet reprodutiv
- Ndikim në humbje të sigurisë njerëzore dhe shkëputje të lidhjeve sociale etj.

Mjafton të shqyrëtojmë procesin e zhvendosjes së fshatit Hade të komunës së Obiliqit për të kuptuar se cila është kostoja e vërtetë e këtij procesi.

*Nga viti 2004 jemi shpallë zonë me interes të veçantë ekonomik...Nuk kemi kushte të zhvillojmë jetë normale në Hade, është vetëm 200 m afër nga operimi me eskavator të rëndë ku gërmohet*

<sup>25</sup> Republika e Kosovës, (2010), Ligji për Miniera dhe Minerale, Neni 33, paragrafi 2, Prishtinë: GZRKS.

*24 orë dhe jemi të ndikuar nga zhurma, tymi, pluhuri e djegia e qymyrit...Nuk kemi të drejtë për me ngritë një fermë apo serë sepse nuk lëshojnë leje nga komuna.<sup>26</sup>*

Pra, tashmë ka kaluar më shumë se një dekadë që procesi i zhvendosjes së Hades nuk është përfunduar. Kostoja sociale e zhvillimit të komunitetit është pothuaj e pariparueshme. Me një kosto të tillë rrezikojnë të përfundojnë edhe projektet e propozuara tani në Kuvend.

Për arsyet e lartpërmendura, ne i kërkojmë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës që:

1. Të votojnë kundër vendimit për shpallje të interesit publik për projektet e kompanive Envidity Energy Kosova LLC përkatësisht Sharr Cem dhe Titan America. Shpallja e interesit publik për këto projekte me impakt mjedisor nuk mund të jetë e ndërlidhur kryekëput me nivelin e investimeve të premtuara. Projekti i kompanisë Envidity përmban kosto të lartë mjedisore dhe sociale dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës, në pejtim me mandatin e tij nuk mund të shpallë me interes publik një projekt që në vetvete rrezikon të shkaktojë dëme të pariparueshme ndaj tokës, ujit dhe ajrit.
2. Të kërkojë nga Qeveria e Republikës së Kosovës që përpara çdo modifikimit të projekteve të sjellë një raport të detajuar të ndikimit në mjedis të projekteve dhe në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës të informojë dhe konsultojë banorët e zonave që do të preken nga projekte të tilla. Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë të drejtë të kenë të gjithë dosjen në dorë para se të votojnë dhe jo të shërbehen me informata të përgjithshme dhe me shifra të mëdha pa mbulueshmëri faktike.
3. Të kërkojnë Qeverisë së Republikës së Kosovës që para se të propozojë projekte që dëmtojnë ambientin, të sjellë në Kuvend Strategjinë e re të Energjisë dhe Ligjin për Eficiencë të Energjisë, të dyja të parapara në programin e Qeverisë dhe të Kuvendit por që pa asnjë arsye janë vonuar të procedohen. Gjithashtu, të silltet në Kuvend Ligji për Rezervat e Detyrueshme të Naftës që është zvarritur deri më tani.
4. Të kërkojnë Qeverisë së Republikës së Kosovës që para se të propozojë projekte të tilla me pretekst zhvillimin ekonomik, të sjellë në Kuvend ligjin e shumëpritur për Trepçën, dhe të bëjë përpjekje që të hapë perspektivën e zhvillimit në minerale të tjera dhe jo të insistojë në linjit.

---

<sup>26</sup> Kuvendi i Kosovës, (2016), Procesverbal i Mbledhjes së 44-të të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, Fjalë e z. Ragip Grajqevci, banor i fshatit Hade, Prishtinë: Kuvendi i Kosovës.